

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6735
E mërkurë, 19 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Osmani: Të mos lejohet të vendosen kritere shtesë për vizat




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RAPORTI I DICK MARTY / KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, U SHKRUAN LETËR KRYETARËVE TË SHTETEVE E TË QEVERIVE TË TË GJITHA VENDEVE ANËTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

RAMA VAZHDON PËRPPJEKJET PËR ZHBËRJEN E RAPORTIT TË DICK MARTYT



Republic of Albania
Prime Minister
Tirana, 17 October 2022
I find you well. I am writing to draw your attention on a question that concerns not only for my country and the people I represent but for all of us who care about justice and human rights, the core values at the heart of the European system - values to which we pay tribute in our daily work and which are being increasingly threatened in the current political predicament.
I am probably aware, in 2008, a former Chief Prosecutor at the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia (ICTY), Carla Del Ponte, in her memoir, Madame Prosecutor. She claimed that heinous crimes had been committed by members of the Kosovo Liberation Army, including first and foremost human organ trafficking.
I am sure that investigations conducted over the course of the last few years have denied forcefully, in Albania, in Kosovo and elsewhere in the Balkans, that investigations, including in Albania, have been conducted in a way that would allow for the issue to end with a simple "nicked up by..."

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, u ka dërguar një letër kryetarëve të shteteve e të qeverive të të gjitha vendeve anëtare të Këshillit të Evropës në vijim të përpjekjes së nisur ndërkombëtarisht me fjalimin para Asamblesë Parlamentare "për heqjen e njollës së turp të trafikimit të organeve njerëzore mbi

kombin tonë dhe mbi vetë Këshillin e Evropës". Rama në këtë letër thekson se nuk ka absolutisht asnjë provë, qoftë në Shqipëri a gjetkë në rajon, për nxjerrje dhe trafikim organesh, e cila do të mund t'i ngarkohej qoftë edhe një pjesëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

KMDLNJ-ja KËRKON TRANSPARENÇË DHE LLOGARIDHËNIE NË BISEDIMET ME SERBINË



VAZHDOJNË ANKESAT NDAJ ZPS-së, AVOKATI I SHALËS: DOKUMENTET PO I MARRIM ME VONESË

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



ZELENSKY: RUSIA KA SHKATËRRUAR 30 PËR QIND TË STACIONEVE ENERGETIKE BRENDA NJË JAVE

INSTITUCIONET TË LUFTOJNË TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE

NJË SERB ARRESTOHET NË HUNGARI, DYSHOHET SE ËSHTË I PËRFSHIRË NË 33 VRASJE

EKONOMI



EKZEKUTOHEN PENSIONET ME SHITESËN PREJ 100 EUROVE

UNICEF: KOSOVA DHE SHQIPËRIA RREZIKOJNË TË BIEN NË VARFËRI NGA SHKAKTIMI I KRIZËS SË LUFTËS

SPORT



KARIM BENZEMA SHPALLET LOJTARI MË I MIRË NË BOTË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky: Rusia ka shkatërruar 30 për qind të stacioneve energjetike brenda një jave

KIEV, 18 TETOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë të martën se forcat ruse kanë "shkatërruar" një të tretën e stacioneve ukrainase të energjisë përmes sulmeve të vazhdueshme që kanë shënjestruar infrastrukturën e energjisë dhe kanë shkaktuar ndërprerje të mëdha të rrymës. "Prej 10 tetorit 30 për qind e stacioneve ukrainase të energjisë janë shkatërruar, duke shkaktuar ndërprerje në gjithë shtetin", ka shkruar Zelensky në "Twitter". Ai ka shtuar se "nuk ka mbetur vend për negociata me regjimin e (presidentit rus, Vladimir Putinit". Disa rajone të Ukrainës, përfshirë

kryeqytetin Kievin, janë përballur me probleme të energjisë, pas valës së re të sulmeve që kanë goditur objektet e energjisë më 18 tetor. Në Kiev, operatori i energjisë, DTEK, ka thënë se ka pasur "ndërprerje" të energjisë dhe ujit për banorët e bregut të majtë të kryeqytetit. "Inxhinierët janë duke kryer hetime dhe janë duke bërë gjithë përpjekjet e nevojshme për ta rikthyer energjinë e banorëve", ka thënë kompania përmes një postimi në "Facebook". Kryetari i Kievit, Vitali Klitschko, u ka bërë thirrje banorëve që ta ruajnë rrymën "sa më shumë që është e mundur" për ta shmangur përdorimin e pajisjeve

që kërkojnë konsum të madh. Disa pjesë të rajonit Zhitomir, në perëndim të Kievit, kanë mbetur pa rrymë si pasojë e sulmeve, ka thënë guvernatori Vitaliy Bunechko. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt. Presidenti rus, Vladimir Putin, e konsideron luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



Australia tërheq njohjen e Jerusalemit Perëndimor si kryeqytet të Izraelit

KANBERRA, 18 TETOR - Australia ka kthyer mbrapsht vendimin e marrë katër vjet më parë për ta njohur Jerusalemin Perëndimor si kryeqytet të Izraelit. Vendimi i Kanberras, i vitit 2018, ka dëmtuar paqen dhe e ka vendosur Australinë jashtë hapit të shteteve të tjera, ka thënë ministrja e Jashtme australiane Penny Wong. Ajo ka theksuar se Australia mbetet "mike" e Izraelit. Ambasada e saj do të qëndrojë në Tel Aviv. Statusi i Jerusalemit është ndër çështjet më kontestuese në mes të Izraelit dhe palestinezëve. Ministria e Jashtme izraelite ka shprehur "zhgënjimin e thellë" ndaj vendimit të Australisë dhe do të marrë në pyetje ambasadorin e këtij shteti, kanë raportuar mediet izraelite. Ish-presidenti amerikan Donald Trump është kritikuar në nivel



global më 2017, kur e ka ndryshuar politikën amerikane, duke njohur Jerusalemin kryeqytet të Izraelit. Ambasada amerikane është bartur nga Tel Avivi në Jerusalem në maj të vitit 2018. Disa muaj më vonë ish-

kryeministri australian Scott Morrison ka thënë se qeveria e tij do të veprojë njëjtë. Atëbotë Morrison ka thënë se Australia do ta njohë Jerusalemin Perëndimor menjëherë, mirëpo nuk do të bartë ambasadën derisa të ketë marrëveshje për paqe.

Qeveria e Morrisonit i ka humbur zgjedhjet në maj të këtij viti. Ministrja e Jashtme, Penny Wong, e ka quajtur vendimin e qeverisë së kaluar si "lojë cinike" për t'i fituar votat e hebrenjve para zgjedhjeve. Kosova, Hondurasi dhe

Guatemala janë shtetet e vetme, përveç Shteteve të Bashkuara, që kanë ambasadat në Jerusalem. Aktualisht edhe Mbretëria e Bashkuar është duke shqyrtuar mundësinë e bartjes së ambasadës në këtë qytet. Izraeli e konsideron Jerusalemin kryeqytet "të pandarë", derisa palestinezët pretendojnë se Jerusalemi Lindor i pushtuar nga Izraeli në luftën e vitit 1967 do të jetë kryeqyteti i shtetit të tyre në të ardhmen. Statusi i Jerusalemit është në qendër të konfliktit izraelito-palestinez. Sovraniteti i Izraelit mbi Jerusalemin nuk është njohur kurrë ndërkombëtarisht. Sipas marrëveshjeve për paqe të vitit 1993, mes izraelitëve dhe palestinezëve, për statusin final të Jerusalemit, palët do të diskutojnë në fazat e tjera të bisedimeve për paqe.

Gjermania zgjat jetën e tri centraleve bërthamore pas krizës me energji

BERLIN, 18 TETOR - Kancelari gjerman Olaf Scholz ka marrë vendim që tri centralet e fundit bërthamore të jenë funksionale deri në mesin e muajit prill të vitit të ardhshëm, pasi kriza e energjisë e nxitur nga lufta e Rusisë në Ukrainë është duke dëmtuar ekonominë. Planet e Gjermanisë kanë qenë që t'i ndalë punimet në të tria centralet, Isar 2, Neckarwestheim 2 dhe Emsland në fund të këtij viti. Gjermania siguron 6 për qind të energjisë elektrike përmes këtyre centraleve. Vendimi për mbylljen e tyre

është marrë nga ish-kancelarja gjermane Angela Merkel pas katastrofës bërthamore në Fukushima më 2011. Mirëpo tani çmimet e gazit janë rritur dukshëm prej nisjes së luftës në Ukrainë. Rusia ka zvogëluar në sasi të konsiderueshme eksportet e naftës dhe gazit drejt Bashkimit Evropian. Perëndimi beson se Rusia është duke përdorur energjinë si armë pas vënies së sanksioneve të ashpra ndaj Moskës për nisje të luftës. Meqë Gjermania është shumë e varur nga energjia ruse,

autoritetet kanë ndryshuar strategjitë për të siguruar rezerva për dimër. Vitin e kaluar Gjermania ka siguruar 55 për qind të gazit që i duhet nga Rusia, mirëpo kjo shifër ka zbritur në 35 për qind gjatë verës dhe ka synime për ulje të mëtejshme. Përveç vazhdimit të punës në centrale bërthamore, autoritetet gjermane kanë marrë vendim për t'i rikthyer në jetë termocentralet me thëngjill, ndonëse plani ka qenë që e gjithë energjia të zëvendësohet me energji efiçente.



Osmani: Të mos lejohet të vendosen kritere shtesë për vizat



Presidentja Vjosa Osmani ka pritur në takime të ndara ambasadorët e akredituar në Prishtinë, atë të Gjermanisë, të Italisë dhe të Sllovenisë, nga të cilët ka kërkuar përkrahje për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se është e rëndësishme që shtetet e Bashkimit Evropian ta respektojnë rekomandimin e Komisionit Evropian sa i përket liberalizimit të vizave dhe të mos lejohet në asnjë mënyrë që të vendosen kritere shtesë. Këto komente Osmani i bëri gjatë takimeve që zhvilloi me ambasadorët e akredituar në Prishtinë nga Gjermania, Italia dhe Sllovenia, të cilëve u kërkoj përkrahje në procesin e

liberalizimit të vizave. Osmani ka biseduar me ambasadorët e këtyre tri shteteve për zhvillimet politike që kanë dalë pas takimit të 13 shtatorit të grupit punues për vizat të Këshillit Evropian. Presidentja Osmani i falënderoi shtetet mike, Gjermaninë, Italinë dhe Slloveninë, për përkrahjen e vazhdueshme që ato ia kanë dhënë Kosovës në procese të ndryshme. Sipas Osmanit, është shumë e rëndësishme që kjo përkrahje të vazhdojë edhe tani, kur Kosova pret që të përmbyllet procesi shumë i rëndësishëm i krijimit të mundësive për lëvizjen e lirë të qytetarëve tanë, procesi

cili e prek drejtpërsëdrejti jetën e tyre.

Presidentja Osmani theksoi se vendet anëtare të BE-së duhet ta marrin parasysh edhe rekomandimin e Komisionit Evropian, i cili tashmë e ka konfirmuar se e mbështet rekomandimin e bërë për heqjen e vizave për Kosovën, meqë shteti ynë i ka plotësuar të gjitha kriteret. "Po kaq e rëndësishme është që të mos lejohet në asnjë mënyrë që të vendosen kritere shtesë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, sepse kjo do të ndikonte në mohimin e një të drejte të qytetarëve tanë dhe do ta lëndonte kredibilitetin e BE-së", ka thënë Osmani.

Presidentja shprehu besimin e saj që kërkesat teknike, lidhur me ETIAS, të mos ndikojnë në vendimarrjen politike dhe caktimin e ditës së hyrjes në fuqi të vendimit për liberalizimin e

vizave për qytetarët e Kosovës.

Presidentja Osmani ka kërkuar, po kështu, edhe përkrahjen e mëtejme të këtyre vendeve për procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës. Sipas presidentes, anëtarësimi në këtë organizatë është shumë i rëndësishëm për qytetarët e vendit, ngaqë u jep atyre mundësi që t'i mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe e ndihmon vendin që t'i avancojë më tej të drejtat e njeriut.

Në takimin e Këshillit Evropian besohet se zyrtarët francezë kanë kërkuar që procesi i liberalizimit të vizave të lidhet me sistemin ETIAS. Kjo gjë është mbështetur prej të paktën katër shteteve të tjera: Suedisë, Belgjikës, Holandës dhe Spanjës.

Pas takimit të 13 tetorit, Presidenca Çeke ka thënë se në mënyrë që të ecet përpara në këtë temë, "është e domosdoshme që

të qartësohen disa çështje dhe të vazhdohen diskutimet".

Takimi i radhës i grupit punues për vizat i Këshillit të BE-së është paraparë të mbahet në nëntor.

Komisioni Evropian ka rekomanduar liberalizimin e vizave për Kosovën në vitin 2018. ETIAS është sistem evropian për autorizim dhe informacione rreth udhëtimit. Ky sistem që është krejtësisht elektronik mundëson verifikimin e të dhënave të qytetarëve të vendeve të treta, që nuk kanë nevojë për vizë, për të hyrë në Zonën Shengen.

ETIAS është kërkuar që të funksionalizohet pas shqetësimeve në rritje për terrorizmin dhe krizën me migrantë në Evropë. Procedura ligjore për ta miratuar sistemin ETIAS ka nisur më 2016 dhe sistemi pritet të jetë plotësisht operacional brenda vitit 2023, pa ndonjë datë të saktë.

Vazhdojnë ankesat ndaj ZPS-së, avokati i Shalës: Dokumentet po i marrim me vonesë



Hagë, 18 tetor - Kritika ndaj punës së Zyrës së Prokurorisë Speciale në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë mbetet një ndër çështjet më të diskutuara në seancat e Gjykatës Speciale.

Kështu të paktën ka ndodhur edhe të martën në seancën e konferencës përgatitore ndaj Pjetër Shalës.

Avokati i tij ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me vonesat e ZPS-së sidomos në nxjerrjen e dokumenteve. Sipas avokatit të Shalës, këtu nuk bëhet

fjalë për dokumente të reja, por dokumente që tashmë ekzistojnë dhe se, sipas tij, janë rreth 500 dokumente që i janë dhënë me vonesë palës së mbrojtjes. "Po na detyrojnë të punojmë sikur po ecim në rërë që rrëshqet tërë kohës. Ne punojmë sipas dokumenteve që na servohen dhe kur i marrim me vonesë, është e vështirë t'i analizojmë dhe t'i përkthejmë. Na duhet kohë që të arrijmë në përgjigjen më të përshtatshme", janë shprehur nga mbrojtja e Shalës. Shala u arrestua më 16 mars 2021

nga autoritetet belge dhe u transferua në Hagë më 15 prill 2021 në bazë të një kërkesë për bashkëpunim në zbatimin e fletarrestimit dhe urdhrit për transferim lëshuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Në aktakuzën e konfirmuar Shala ngarkohet me përgjegjësi penale individuale në formë të ndryshme për krime lufte si ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme, të kryera në kontekstin e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe në lidhje me këtë konflikt.



RAPORTI I DICK MARTY / KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, U SHKRUAN LETËR KRYETARËVE TË SHTETEVE E TË QEVERIVE TË TË GJITHA VENDEVE ANËTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

Rama vazhdon përpjekjet për zhbërjen e raportit të Dick Martyt


Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, u ka dërguar një letër kryetarëve të shteteve e të qeverive të të gjitha vendeve anëtare të Këshillit të Evropës në vijim të përpjekjes së nisur ndërkombëtarisht me fjalimin para Asamblesë Parlamentare “për heqjen e njollës së turpit të trafikimit të organeve njerëzore mbi kombin tonë dhe mbi vetë Këshillin e Evropës”. Rama në këtë letër thekson se nuk ka absolutisht asnjë provë, qoftë në Shqipëri a gjetkë në rajon, për nxjerrje dhe trafikim organesh, e cila do të mund t'i ngarkohej qoftë edhe një pjesëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pas fjalimit të “ashpër” në Asamblesë të Këshillit të Evropës ditë më parë në Strasburg, ua ka drejtuar një letër kryetarëve të shteteve e të qeverive të të gjitha vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, të cilëve u bënë thirrje për heqjen e njollës së turpit të trafikimit të organeve njerëzore mbi kombin tonë.

Rama e ka bërë publike letër në “Facebook”, ku bën me dije se më 17 tetor është firmosur kjo letër dhe u është dërguar të gjithë krerëve të KiE-s, duke e çuar debatin për heqjen e akuzave ndaj Kosovës në një tjetër stad. “Shpresoj që kjo letër

t’ju gjejë mirë. Po ju shkruaj për ta kërkuar vëmendjen tuaj për një çështje thelbësore, jo vetëm për vendin dhe popullin që përfaqësoj, por për të gjithë ne. Kjo çështje ka të bëjë me drejtësinë dhe të drejtat e njeriut, vlera bazë në themel të çdo sistemi demokratik - ato vlera të cilat i nderojmë në punën tonë të përditshme e që kërcënohen gjithmonë e më shumë në situatën politike aktuale. Ashtu siç mund të jeni në dijeni, në vitin 2008, një ish-prokurore e Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (GjNPIJ), Carla Del Ponte, botoi librin e saj me kujtime, ‘Zonja Prokurore’. Aty ajo pretendonte se pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kosovës kishin kryer krime të



tëmerrshme, përfshirë, mbi të gjitha, trafikim të shfrenuar të organeve njerëzore”, thuhet në letër e Ramës.

Më tej theksohet se akuzat e saj u mohuan me forcë në Shqipëri, Kosovë dhe tjetërkund në rajon, për arsyen e thjeshtë se hetimet

e kryera përgjatë disa viteve nga kryeprokuroreja e GjNPIJ-së, përfshirë Shqipërinë, kishin qenë tërësisht jobindëse. “Kjo duhej të kishte mjaftuar që çështja të mbyllej aty ku kishte nisur: në faqet e një trillimi joletrar. Përkundrazi, ajo u çua më tej nga të tjerë, konkretisht nga anëtarët e partisë ‘Rusia e Bashkuar’ e Putinit në Këshillin e Evropës, të cilët e instrumentalizuan atë për të ushqyer më tej narrativën ruse mbi Kosovën. Më pas, Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës iu paraqit një raport (sërisht në mungesë provash). Nisur nga raporti dhe serioziteti i akuzave, në janar 2011 Asambleja miratoi rezolutën 1782, titulluar ‘Hetimi i akuzave për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të organeve njerëzore në Kosovë’. Njëmbëdhjetë vjet më vonë të gjitha përpjekjet për hetime të bëra qysh atëherë, kombëtarisht, në rajon a ndërkombëtarisht, për t’i provuar pretendimet për trafikimin e organeve njerëzore, ia kanë dalë të vërtetojnë atë që dihej: nuk ka absolutisht asnjë provë, qoftë në Shqipëri a gjetkë në rajon, për nxjerrje dhe trafikim organesh, e cila do të mund t’i ngarkohej qoftë edhe

Institucionet ta luftojnë trafikimin e qenieve njerëzore

PRISHTINË, 18 TETOR - "Dita e Bashkimit Evropian Kundër Trafikimit na shërben jo vetëm të kujtojmë e t'i nderojmë viktimat e trafikimit, por më shumë të kujtojmë e të zotohemi, bashkë të gjithë, për nevojën për ta çrrënjësuar këtë formë të krimit anembanë", ka thënë të martën kryeministri Albin Kurti në shënim të kësaj dite.

Kryeministri ka theksuar se si qeveri, në bashkëpunim me të gjithë, duhet punuar për ta përmirësuar gjendjen, veçanërisht në lidhje me identifikimin proaktiv të viktimave, duke siguruar ndihmë e mbështetje, si dhe duke rritur ndjekjen dhe

dënimin merit të autorëve të krimit. "Vetëm këtë vit kemi 15 viktimat të trafikimit, 14 prej të cilave janë vajza, prej të cilave 11 nën moshën 18-vjeçare. 11 nga viktimat janë shfrytëzuar në prostitucion të detyruar, 3 për punë të detyruar dhe 1 për kërkim-lëmshë", ka thënë Kurti, duke shtuar se si numra mund të mos duken shumë, por pas këtyre numrave kemi emra e mbiemra, kryesisht fëmijë, vajza e djem të ri.

Kryeministri Kurti ka theksuar se luftimi i këtij krimi është urgjent dhe i domosdoshëm dhe se institucionet duhet të jenë të pakompromis në luftimin e kësaj dukurie. Ai ka thënë se detyra të qeverisë mbeten

luftimi dhe adresimi i arsyeve kryesore të trafikimit, sikurse që janë varfëria, zhvillimi i dobët ekonomik, niveli i ulët i edukimit dhe i vetëdijes. "Për këtë, si Qeveri e Kosovës kemi projekte e plane konkrete të investimit në ekonomi dhe në edukim, por edhe mbrojtje e siguri për të gjithë, në veçanti për grupet më të cenueshme, si: fëmijët, komunitetet e marginalizuara të romëve, ashkalinjve dhe egiptianëve, personat LGBTQI+, migrantët, azilkërkuarit e refugjatët, të cilët janë në rrezik më të madh ndaj trafikimit", ka thënë Kurti.

Kryeministri ka vlerësuar angazhimin e Policisë së Kosovës për identifikimin e

grupeve kriminale për hetimin e trafikimit të qenieve njerëzore, që ka shënuar përparim. "Që nga viti 2021 e deri më sot për veprat penale të kësaj natyre (trafikim, mundësim dhe marrje me prostitucion etj.), janë arrestuar 353 persona të dyshuar dhe janë ngritur 128 kallëzime penale ndaj 257 personave të përfshirë, kurse për periudhën e njëjtë, vetëm për trafikim të njerëzve, janë arrestuar 68 persona, janë ngritur 31 kallëzime penale ndaj 80 personave të përfshirë", ka bërë me dije kryeministri Kurti.

Në shënim të kësaj dite Ministria e Punëve të Brendshme lansoi fushatën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Krahas kryeministrit Kurti, në këtë ceremoni morën pjesë edhe presidentja Vjosa Osmani-Sadriu, ushtruesi i detyrës i kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, koordinatori Nacional Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, njëherësh zëvendësministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, si dhe përfaqësues të lartë të kryeprokurorisë të shtetit, drejtorisë së Policisë së Kosovës, Bashkimit Evropian, Këshillit Evropian, Ambasadës Amerikane, organizatës IOM si dhe institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës.



një pjesëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për më tepër, aktakuzat e paraqitura nga Dhomat e Specializuara në Hagë nuk përmbajnë as dhe një fjalë të vetme lidhur me nxjerrjen dhe trafikimin e pretenduar të organeve njerëzore", thuhet në letrën e kryeministrit të Shqipërisë.

Për të vazhduar më tej se: "Sado e çuditshme të duket kjo, nuk ka fakte, nuk ka autorë, nuk ka viktimat të trafikimit të organeve njerëzore. Raporti dhe rezoluta që pasoi nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës u mbështetën më tepër në spekulime sesa në fakte, në thashetheme që qarkullonin në vend të provave. Ato tanimë janë kthyer në një njollasje të pamerituar të atyre që janë

akuzuar pa të drejtë dhe në një turp për politikën ndërkombëtare".

Rama ua kujton kryetarëve të shteteve e qeverive të të gjitha vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, se më 12 tetor 2022 këto argumente i ka paraqitur përpara Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ku ka bërë thirrje për hartimin e një raporti vijues. "Çështja ka një rëndësi sipërore jo vetëm për t'i mbrojtur të drejtat e individëve të akuzuar padrejtësisht për krime që nuk i kanë kryer kurrë. Ajo nuk ka thjesht të bëjë me mbrojtjen e procesit të rregullt ligjor përmes procedurave të gjykatës, një proces i rregullt që duhet të jetë i drejtë e i pa të meta. Por ka të bëjë me qytetarët e vendit tim,

Shqipërisë, që vazhdojnë të jenë shënjestër e stereotipave të rrezikshme e të pabaza si ky dhe viktimat të armiqësisë e të ksenofobisë që akuzat të tilla ushqejnë. Ka të bëjë, gjithashtu, me të vërtetën dhe drejtësinë, pa të cilat minohet vetë integriteti e besueshmëria e politikës ndërkombëtare dhe e institucioneve të saj. Për dijeninë tuaj, po ju bashkëlidh një kopje të fjalës sime të mbajtur përpara Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, si dhe një kopje të rezolutës së miratuar për këtë çështje nga Kuvendi i Shqipërisë", thotë Rama në këtë letrë.

Kryeministri i Shqipërisë pret mbështetje në këtë drejtim nga kryetarët e shteteve dhe

qeverive të të gjitha vendeve anëtare të Këshillit të Evropës. "Shpresoj në mbështetjen tuaj personale dhe atë të anëtarëve të delegacionit të vendit tuaj në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për miratimin e kërkesës sonë, për nisjen e procedurës që do të çojë në një raport vijues, si korrigjim i ndershëm dhe i domosdoshëm i një gabimi tragjik, pasojat e të cilit vazhdojnë të na përndjekin", ka thënë Rama në fund të letrës.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, më 12 tetor i është drejtuar Këshillit të Evropës për ta kërkuar rishikimin e raportit të Dick Martyt dhe për t'i shpallur të pabaza akuzat e tij për trafikim të organeve njerëzore gjatë Luftës Çlirimtare

në Kosovë. Gjatë fjalës së tij, Rama i ka hedhur poshtë të gjitha pretendimet e raportit duke i analizuar të gjitha pikat e tij. Ai ka thënë se ky raport është një fantazi e pastër e fabrikuar në Kremlin dhe i sjell në Këshillin e Evropës. "Ju bëj thirrje t'i rrëzoni akuzat kundër Kosovës. Ju bëj thirrje ta pranoni kërkesën e Shqipërisë që ta rrëzoni një rezolutë që degradon luftëtarët e Ushtrisë heroike Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Rama.

Kuvendi i Shqipërisë më 21 korrik ka miratuar rezolutë përmes së cilës kërkohet që akuzat e raportit të Martyt të konsiderohen të paargumentuara, të paprovuara dhe të pabazuara në prova dhe fakte.

Nis ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve edhe në Livoç të Epërm dhe në Livoç të Ulët

GJILAN, 18 TETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka vazhduar vizitat në terren për ta parë nga afër

zhvillimin e punimeve në infrastrukturë. Kësaj radhe kreu i Gjilanit ka vizituar punimet e ndërtimit dhe

asfaltimit të rrugëve në Livoç të Epërm dhe Livoç të Ulët. Ditë më parë kryetari Hyseni ka parë nga afër punimet për

rregullimin e rrugëve edhe në fshatin Haxhaj. "Po punojmë në çdo cep të komunës", ka thënë kryetari Hyseni.



Një serb arrestohet në Hungari, dyshohet se është i përfshirë në 33 vrasje



PRISHTINË, 18 TETOR - Të martën e 18 tetorit një shtetas serb është arrestuar në Budapest të Hungarisë pas kërkesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Lajmin për "Albanian Post" e ka konfirmuar kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj. "Përmes kërkesës së Prokurorisë Speciale është lëshuar nga gjykata letërrreshtimi

ndërkombëtar në bazë të të cilit është arrestuar ky person. Ai dyshohet se ka marrë pjesë në vrasjet që kanë ndodhur në rajonin e Pejës dhe shumë shpejt pritet të ekstradohet në Kosovë porsa të përfundojnë të gjithë procedurat", ka deklaruar Isufaj. Edhe më 3 qershor një qytetar serb është arrestuar për krime lufte të kryera ndaj popullatës

civile në Kosovë në periudhën gjatë viteve 1998-1999. I njëjti me vendim të prokurorit është dërguar në mbajtje dhe rasti është nën hetime. Ai është i akuzuar për rrahjen e një kosovari nga fshati Gurrakoc pak para përfundimit të luftës. I njëjti akuzohej edhe për tortura dhe maltretim të popullsisë civile në Istog si rezervist në ish-policinë serbe.

Drejtorët e komunës i raportojnë Totajt për punën njëjavore



PRIZREN, 18 TETOR - Në prani të medieve dhe shoqërisë civile, nën monitorimin e OSBE-së, të martën kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka mbajtur mbledhjen e përvjetshme me drejtorët e komunës, të cilët kanë raportuar për arritjet javore dhe planifikimin për ditët në vijim. Në këtë mbledhje u tha se javën që lëmë pas ka vazhduar realizimi i projekteve kapitale në komunën e Prizrenit, ku janë bërë intervenime infrastrukturore në fshatrat e

Zhupës e në Petrovë, është intervenuar në pusetat e rrjetit të kanalizimit në komunën e Prizrenit. Janë hapur ofertat për dekorimin e qytetit për festat e fundvitit si dhe për parkun në lagjen Dardania. Në vazhdim është theksuar se do të bëhet asfaltimi i rrugicave në fshatin Gjonaj. "Po vazhdon shpërndarja e librave për nxënësit nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Komunale të Arsimit si dhe po bëhet furnizimi i shkollave

me lëndë djegëse për stinën e dimrit. Gjatë javës së kaluar është bërë shpërndarja e pakove për fëmijë me aftësi të kufizuara, donacion nga Turqia. Gjithashtu, është realizuar programi trevjeçar i banimit social si dhe në proces është projekti për ndërtimin e shtëpive, rregullimin e kulmeve dhe renovimeve për familjet në nevojë. Në aspektin urbanistik do të lehtësohen procedurat për investitorët në mënyrë që pajisja

me leje, sidomos për ndërtime të larta, të bëhet më shpejt", ka njoftuar Komuna e Prizrenit. Po ashtu, u theksua se Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka hapur thirrjen për fermerë për aplikim për freza, motokultivatorë dhe spërkatëse 400 litra. "Inkurajohen fermerët të aplikojnë në projektin 'Furnizim me mekanizëm bujqësor', me bashkëfinancim. DKRS-ja po bën përgatitjen e festave që përfshijnë

organizimin e festivalit 'Zambaku i Prizrenit' dhe festivalin 'Flutrat' si dhe po punohet për strategjinë e sportit të Republikës së Kosovës që sot do të bëhet raporti final i kushteve që i ofron komuna e Prizrenit në këtë kontekst", ka njoftuar komuna e Prizrenit. Prizreni javën e kaluar është bërë pjesë e qyteteve të vjetra të botës gjë që do ta ngrehë në nivel tjetër turizmin dhe zhvillimin ekonomik të qytetit.

Florentina Osmani emërohet drejtoreshë e Drejtorisë së Inspeksionit

PODUJEVË, 18 TETOR - Me vendim të kryetarit të komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, Florentina Osmani është emëruar drejtoreshë e Drejtorisë së

Inspeksionit. Florentina Osmani ka përfunduar studimet themelore në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin Juridik, po ashtu edhe studimet e

nivelet master në Fakultetin Juridik në Drejtimin Kushtetues. Ka punuar për disa vjet me projekt të Institutit të Kosovës për Drejtësi në Gjykatën

Themelore të Prishtinës - Dega në Podujevë. Pas emërimit të Osmanit në krye të këtij dikasteri, kryetari Bulliqi i ka uruar suksese në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi.



KMDLNj-ja kërkon transparencë dhe llogaridhënie në bisedimet me Serbinë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 TETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka vlerësuar se bisedimet me Serbinë po vazhdojnë në një terr thuaja të plotë informativ. “Qytetarët e Kosovës si fitues të zgjedhjeve të fundit e që ia dhanë besimin mbi 50 për qind koalicionit që aktualisht kanë pushtet absolut kanë pritur se do të ketë transparencë më të madhe sidomos për ecurinë e këtyre bisedimeve. Kohën e fundit në opinion po qarkullojnë disa modele për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare me Serbinë për normalizim të marrëdhënieve, ndërsa mbizotërues është propozimi francez -gjerman që preferon modelin e dy gjermanive”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Në lidhje me këtë proces të dialogut, KMDLNj ka komentuar edhe vizitat e shpeshta të emisarëve të këtyre shteteve në Prishtinë. “Kishte vizita të shpeshtuara të emisarëve të këtyre shteteve e që ua kanë dorëzuar draftpropozimin kryeministrit Kurti ne Prishtinë dhe presidentit serb Vuçiq në Beograd. Në kohën kur Vuçiqi e pranoi se është një kornizë e re për bisedime, kryeministri Kurti është deklaruar se nuk ka një të tillë për ta pranuar më në fund se, megjithatë, është një propozim i palëndëzuar. Ka filluar presioni i ndërkombëtareve që të pranohet ky propozim sepse ai i radhës



© Bahri Cani/DW

mund të jetë më i keq. Shantazh dhe presion klasik dhe, në këtë luftë të pandershme, po shquhet eurodeputetja Viola von Kramon dhe ca të tjerë. Për habi, opozita nuk po insiston që të sigurohet kjo transparencë për bisedime ndonëse e ka detyrim ndaj votuesve”, theksohet në reagimin e KMDLNj-së.

Tutje thuhet se opozita, duke luajtur rol pasiv, është duke marrë pjesë në mjegullimin e procesit të bisedimeve, në ndërkohë që, sipas KMDLNj-së, do të duhej t'i përdorte të gjitha mjetet

parlamentare për ta detyruar kryeministrin e Kosovës të raportojë në baza të rregullta për këto bisedime. “Shoqëria civile është krejtësisht pasive për dallim që më herët, gjatë legjislaturave të kaluara ishte, me të drejtë, e zhurmshme për sigurimin e transparencës. Mos të flasin se si sillet pozita aktuale që përdori të gjitha mjetet e padhunshme dhe të dhunshme, në emër të sigurimit të transparencës për bisedime. Nuk ka asnjë kuptim pohimi i opozitës se nuk e pengojmë procesin e bisedimeve

dhe do ta votojmë çdo marrëveshje që e sillni në Kuvend pa pasur fare informata për ecurinë e këtyre bisedimeve”, theksohet në këtë reagim. KMDLNj-ja ka vlerësuar se opozita duhet të jetë bashkëpunuese, por duhet të insistojë në sigurimin e transparencës sepse ia ka premtuar qytetarëve në këmbim të votës. “Presionet ndaj pozitës dhe opozitës do të shtohen ditët në vijim në mënyrë që të arrihet një marrëveshje shkel dhe shko e që nuk është kurrfarë zgjidhje që

siguron qëndrueshmëri. Modeli i dy gjermanive nuk e zgjidh problemin, por e bën më të ngatërruar duke e prolonguar për një afat dhjetëvjeçar. Qytetarët nuk mund të vendosen para aktit të kryer dhe të informohen pasi të jetë arritur marrëveshja. Përgjegjësinë për këtë do ta ketë pozita, e pakundërshtuar nga opozita. Askush në këtë situatë nuk duhet ta ketë synim rrëzimin e qeverisë Kurti 2, por duhet të ketë synim sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies”, theksohet në reagimin e KMDLNj-së.

Osmani dhe Kurti takohen me deputetët portugezë, kërkojnë që liberalizimi i vizave të mos mbetet peng

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti janë takuar të martën me delegacionin e Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit të Portugalisë, i kryesuar nga kryetari i këtij komisioni, Sergio Souza Pinto.

Presidentja Osmani me delegacionin portugez ka diskutuar për raportet ndërshtetërore dhe mbështetjen e Portugalisë për sa i takon procesit të liberalizimit të vizave dhe anëtarësimit në Këshillin e Evropës. “Me delegacionin portugez presidentja Osmani ka diskutuar për raportet ndërshtetërore dhe mbështetjen e Portugalisë për sa i takon procesit të liberalizimit të vizave dhe anëtarësimit në Këshillin e



Evropës”, është thënë nga zyra e Presidencës.

Sipas Osmanit, Komisioni Evropian ka rekomanduar heqjen e vizave për Kosovën, ngaqë Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret. “Prandaj, vendimmarrja politike gjatë Presidencës Çeke është më se urgjente dhe hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave nuk duhet të

mbetet peng i asnjë teknikaliteti”, ka pohuar presidentja Osmani.

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim delegacionin nga Parlamenti i Portugalisë.

Në njoftimin për medie të Kryeministrit është thënë se “si vend mik dhe aleat i Kosovës ai konfirmoi mbështetjen e



Portugalisë drejt integritit të plotë të Kosovës në strukturat euroatlantike, BE dhe NATO”.

Sa iu përket marrëdhënieve të mira dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Portugalisë, kryeministri Kurti bëri ftesë për rritje të shkëmbimeve tregtare, kulturore dhe ekonomike teksa e njoftoi delegacionin me indikatorët më të fundit ekonomikë

dhe demokratikë të vendit si dhe mundësitë që Kosova ofron për investitorë të huaj.

Kryeministri Kurti ka falënderuar Portugalinë për mbështetjen e hershme dhe të vazhdueshme ndaj vendit, popullit dhe shtetit tonë, “veçanërisht në fushën e sigurisë nëpërmjet trupave të saj në kuadër të misionit të KFOR-it”.

Përurohët renovimi i soliterave në lagjen Ulpiana



Prishtinë, 18 tetor - Në praninë e sheshe ekzekutive të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), Alice Albright, ambasadorit amerikan Jeff Hovenier, ministres së Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama, është bërë përurimi i renovimit të soliterave në lagjen e Ulpianës. Albright tha se partneriteti i MCC-së me Kosovën ka filluar në vitin 2017 dhe do të vazhdojë edhe më tutje. "Partneriteti i

MCC-së me Kosovën ka filluar në vitin 2017, kur kemi bërë nënshkrimin e 49 milionë dollarëve për Programin Threshold. Në muajin korrik MCC-ja dhe Qeveria e Kosovës kanë nënshkruar një kontratë të re prej 202 milionë dollarëve për Programin Kompakt, që do të sigurojë investim më të madh në vend", tha Albright.

Ambasadori Hovenier theksoi se ShBA-ja do ta ndihmojë Kosovën në kapërcimin e krizës

energjetike. "Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është duke e ndihmuar që të zvogëlojë këtë varësi që e ka na thëngjill, në afat të shkurtër dhe të mesëm, dhe kjo është një nga arsyet dhe mënyra e vetme se si mund të ndihmohet Kosova. Pra, na vjen mirë që jemi duke ndihmuar për ta rritur eficiencën", theksoi Hovenier.

Ndërsa ministrja Rizvanolli u shpreh se ShBA-ja ka vazhduar të jetë partner kyç në sektorin e

energjisë. "ShBA-ja ka vazhduar të jetë partner kyç në sektorin e energjisë, duke na ndihmuar në tranzicionin tonë energjetik, në burimet e ripërtishme, tani edhe në eficiencë. Mësimet që janë nxjerrë nga këto investime janë tejet të rëndësishme nga investimet që do të vijnë nga Qeveria e Kosovës", u shpreh Rizvanolli.

Për kryetarin Rama ky investim është një transformim për kryeqytetin. "Këto ndërtesa kanë

qenë brendi i kryeqytetit, e janë parë nga pikat e ndryshme dhe, për fat të keq, për një periudhë të madhe kanë qenë ashtu të rrënuara, të shëmtuara dhe të pasigurta. Ky investim është një transformim për kryeqytetin", përfundoi Rama.

MCC-ja deri më tani ka ndarë 11 milionë euro për kursimin e energjisë, ku 1 mijë shtëpi janë izoluar tërësisht dhe mbi 20 banesa në shtatë qytete të Kosovës.

UNICEF: Kosova dhe Shqipëria rrezikojnë të bien në varfëri nga shkaktimi i krizës së luftës



Prishtinë, 18 tetor - Përmes një raporti të UNICEF-it, Kosovës dhe Shqipërisë pritet t'i shtohet numri i të varfërve në vend, si rrjedhojë e ndikimit që do të ketë lufta në Ukrainë në ecurinë ekonomike të vendit. Për Kosovën shifra është 41.5 mijë persona, ndërsa për Shqipërinë raporti gjen se nga 35.4 mijë persona që do të bien në varfëri në Shqipëri, rreth 9 mijë prej tyre janë fëmijë.

Kjo rritje e varfërisë për rreth 6 000 fëmijë do të përkthehet në 743 vjet të humbura shkollimi, vlerëson UNICEF, që është programi i Kombeve të

Bashkuara për Fëmijët. Kurse sipas shifrave në rajon, në Serbi pritet t'i shtohen listës së të varfërve 28 mijë persona, në Bosnjë 17 mijë në Maqedoninë e Veriut 5.5 mijë dhe në Mal të Zi 913.

Sipas këtij raporti, lufta në Ukrainë dhe rritja e kostos së jetesës si pasojë e saj ka zhytur miliona fëmijë të tjerë në varfëri në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore në muajt e fundit.

Në raport thuhet se fëmijët përbëjnë 25 për qind të popullsisë, ata përbëjnë gati 40 për qind të 10.6 milionë njerëzve shtesë në varfëri këtë

vit. "UNICEF po jep alarmin për pasojat e kësaj lufte dhe po u bën thirrje qeverive të ofrojnë mbështetje jashtëzakonisht të fortë për mbrojtjen sociale dhe të zbatojnë programe të ndihmës në para për familjet më të rrezikuara me fëmijë", tha Adeline Hazan, presidente UNICEF France, për AFP.

Në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore rritja e varfërisë mund të rezultojë në 4 500 fëmijë të tjerë që të vdesin para ditëlindjes së tyre të parë dhe 117 mijë fëmijë të tjerë ta braktisin shkollën vetëm në vitin 2022. /Albanianpost.com

Ekzekutohen pensionet me shtesën prej 100 eurove

Prishtinë, 18 tetor - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar të martën se është bërë pagesa e pensioneve bashkë me shtesën prej 100 eurove. Sipas Muratit, nga kjo shtesë e menjëhershme për muajin tetor

kanë përfituar 233 mijë pensionistë. "Është bërë edhe pagesa e pensioneve bashkë me shtesën e njëhershme prej 100 eurosh për muajin tetor, nga e cila kanë përfituar 233 mijë pensionistë që janë

kualifikuar. Kjo përbën shtesën e tretë brenda 12 muajve të fundit që si qeveri kemi bërë për t'i mbështetur pensionistët - në nëntor të vitit të kaluar, në prill të këtij viti dhe tani në tetor", ka njoftuar Murati.



Ç'armatosuni! Apeli i Ajnshtajnit kundër armëve bërthamore

“Fitorja është arritur, por jo paqja” (A.Ajnshtajn 1945)



Manifesti Rasëll – Ajnshtajn, është një deklaratë e paraqitur për mediat nga filozofi i njohur anglez Bertrand Rasëll, edhe në emër të shkencëtarit të famshëm gjerman Albert Ajnshtajn më 9 korrik 1955, në fillim të së ashtuquajturës Luftë e Ftohtë, dhe ishte pjesë e një fushate që synonte ç'armatimin bërthamor

Londër, 9 korrik 1955. Nuk kishin kaluar as dy muaj nga vdekja e shkencëtarit të famshëm, Në një dhomë të mbushur me gazetarë në Caxton Hall, rezidenca që priti Konferencën e parë Pan-Amerikane dhe ngjarje të tjera historike, filozofi Bertrand Rasëll, nisi të lexojë me një zë të dobët një mesazh që i kishte lënë amanet Ajnshtajni në lidhje me rreziqet e luftës bërthamore, i bashkë-shkruar dhe nënshkruar nga 9 studiues të tjerë të shquar.

Tre faqe të shkruara me makinë shkrimi iu dërguan studiuesve nga e gjithë bota dhe njerëzve të thjeshtë. Synimi ishte ambicioz: t'u kërkohej qeverive, që gjendeshin në një udhëkryq midis “vdekjes universale të specieve njerëzore dhe një parajse të re”, të hiqnin dorë nga lufta dhe të gjenin “njete paqësore për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve midis tyre.

“Nuk ka asnjë alternativë tjetër. Në çdo luftë të ardhshme do të përdoren me siguri armët bërthamore, dhe ato e kërcënojnë vazhdimin e ekzistencës së njeriut një Tokë” - thuhej ndër të tjera në

dokument”. Kështu lindi manifesti më i famshëm kundër bombës bërthamore.

Rasëll kishte vënë gjithçka mbi emrin e shkencëtarit më të famshëm të shekullit XX, që ndërroi jetë më 18 prill 1955 në Spitalin e Universitetit Princeton, menjëherë pasi dërgoi letrën ku shprehte miratimin për tekstin e manifestit.

Nënshkruesi më i ri në moshë i dokumentit ishte Jozef Rotblat (1908-2005), një fizikant polak që emigroi në Britaninë e Madhe. Më vonë do të fitonte Çmimin Nobel për Paqe me shoqatën “Pugvash”, që lindi e frymëzuar rreth manifestit pacifist.

Pas vdekjes së Ajnshtajnit, Rotblat tha: “Kohët e fundit ai kishte shfaqur shqetësim mbi situatën botërore, dhe kishte shprehur frikën se popujt mund të shfarosnin njëri-tjetrin duke vënë në zbatim zbulimet e tij shkencore. Ai ishte shumë pesimist për këtë gjë. Fizikanti gjerman e dinte se formula “masa është e barabartë me energjinë”, kishte ndihmuar në nxitjen e reaksionit zinxhir për të

ndërtuar bombën bërthamore. Por në fillim ai dhe Rotblat, mendonin se bomba atomike ishte një ide e mirë.

Gara nisi në vitin 1939 me zbulimin nga gjermanët Oto Hahn dhe Fric Shtrasman të shpërbërjes së uraniumit që bombardohej me neutrone, dhe përfundoi 6 vjet më vonë me shpërthimin e “Little Boy”, bombës atomike që hodhën amerikanët mbi qytetin japonez të Hiroshimës në orën 8:14 të mëngjesit të 6 gushtit 1945.

Rotblat kuptoi se nëse prishet atomi i uraniumit, mund të prodhojë më shumë neutrone dhe ndarje në zinxhir, duke çliruar një energji shkatërruese në më pak se 1 mikrosekondë. Në verën e vitit 1939, një studim gjerman raportoi mundësinë e krijimit të një pajisje bërthamore, ndërsa më 1 shtator Rotblat përgëzoi për Çmimin Nobel në Fizikë shkencëtarin Xhejms Çeduik, zbuluesi i neutronit.

Disa muaj më vonë, ai nisi të bashkëpunonte me të dhe Frish në Liverpul mbi një projekt bërthamor britanik. Ndërkohë në Nju Jork, fizikanti Leo Zilard po konsultohet me Enriko Fermin. Të dy arritën në përfundimin se nuk kishte kohë për të humbur gjermanët, që ishin të parët që arritën ta ndanin atomin, ishin në avantazh në këtë garë, dhe mund të mbështeteshin tek një tjetër emër i madh i fizikës: Verner Hajzenberg, Hungarezët Zilard dhe Eugjen

Vigner (Çmimi Nobel në Fizikë në vitin 1963) dhe Teler, babai i bombës me hidrogjen, iu drejtuan Ajnshtajnit (Zilard kishte punuar me të në një projekt). Ata e bindën që t'i shkruante më 2 gusht presidentit amerikan Ruzvelt: “Muajt e fundit është bërë e mundur kryerja e një reaksioni bërthamor zinxhir mbi një masë të madhe uraniu-mi.

Ky fenomen i ri do të çonte në krijimin e bombave. Dhe është e imagjinueshme ndërtimi i bombave tejet të fuqishme të një lloji krejtësisht të ri. Një pajisje e vetme e shpërthyer në një port, mund të shkatërrojë portin dhe gjithë zonën përreth. Ndaj amerikanët duhet të nxitojnë me projektin e tyre” - theksonte ndër të tjera Ajnshtajni.

Deri në atë moment, babai i “Relativitetit të Përgjithshëm” nuk dukej shumë pacifist: çdo lloj arme ishte e mirë kundër Adolf Hitlerit. Por letra nuk pati efektin e dëshiruar, dhe presidenti vendosi mbi ndërtimin e bombës bërthamore vetëm më 9 tetor 1941.

Fatmirësisht në vitin 1942 gjermanët e braktisën idenë e tyre për shkak të mungesës së mjeteve. “Po ta dija që nuk do të kishin mundur ta ndërtonin, nuk do t'ia kisha rekomanduar këtë projekt SHBA-së” - do të thoshte më vonë Ajnshtajni. Në vitin 1944, Rotblat mori konfirmimin nga shërbimet sekrete se bomba gjermane nuk do ta ndërtohej ndonjëherë, dhe u tërhoq nga

Projekti Manhattan (programi kërkimor që çoi tek bomba atomike). Ndërkohë Zilard, do të kundërshtonte - edhe pse më kot - hedhjen e bombave mbi Japoni.

Më 11 shkurt 1955 Rasëll i shkroi një letër Ajnshtajnit, ku kërkonte që njerëzit e shkencës të bëjnë “diçka spektakolare, për t'i nxitur njerëzit dhe qeveritë të kuptojnë se këto armë mund të shkaktojnë katastrofa, dhe të theksojnë fuqishëm idenë se lufta mund të nënkuptojë zhdukja e jetës në planetin tonë”.

Ajnshtajni që e kishte kuptuar potencialin shkatërrues të këtyre armëve e pranon propozimin, duke hedhur idenë e hartimit të një deklaratë publike. Filozofi e shpërndau dhe në prill dokumenti u firmos nga Ajnshtajni.

“Bomba me hidrogjen mund të zhdukë qytete si Londra, Nju Jorku apo Moska. Por ajo mund të bëjë dëme në një zonë shumë më të madhe për shkak të radioaktivitetit. Armët 2500 herë më të fuqishme se sa bomba që goditi Hiroshimën, na detyrojnë t'i përgjigemi pyetjes: Lufta do t'i japë fund racës njerëzore, apo njerëzimi do të heqë dorë nga lufta?

Meqenëse askush nuk do të refuzojë ta përdorë këtë bombë për të fituar, një pakt për heqjen dorë nga ajo dhe reduktimin e këtyre armëve do të ishte i rëndësishëm, por jo vendimtar. Nëse duam që të shpëtojmë, duhet anuluar vetë lufta si mjet dhe jo armët” - shkruante Ajnshtajni. / Focus - Bota.al

Në Stamboll, Preng Pasha, Gani dhe Esat Toptani, qisnin pushkë pa nda, deheshin e bënin zhurmë duke e bezdisur edhe Sulltanin

Nga kujtimet e Hamid GJYLBEGAJT
Përgatiti për botim: Shefqet DELIALLISI

Me largimin nga Shkodra të Malit të Zi, më 17 janar 1916 hyri Austria. Oficeri politik austriak, lejtnan Tashi, në Bashkinë e Shkodrës shpalli një urdhër, nëpërmjet të cilës kërkonte paraqitjen në bashki të personave që kishin kryer me diplomë shkollë të larta. Me këtë rast u paraqitën: doktor Saraçi, avokat Qazim Dani dhe unë, si akademik ushtarak. Mbasi i tregova dokumentin e kërkuar, oficeri austriak më propozoi që të merrja në dorë drejtimin e Policisë së Shkodrës. I thashë se nuk isha oficer policie, por i trupave aktive. Mbasi ai këmbënguli, unë kërkova kohë derisa të ktheheshin një pjesë oficerëve shqiptarë që ishin në Mal të Zi. Më pas do të vendosnim, mbasi të shikonim se si Austria do ta konsideronte Shqipërinë. I nevrkosur me qëndrimin tim, më nxori jashtë.

Kështu u shkëputa nga kjo degë administrative. Në vendin tim u emërua "ober oficial", Drejtor Policie, Hilë Mosi, dhe si togerë ofical, Ymer Ruzhdia – Ulqinaku, dhe Ymer Kopliku. Të nesërmen, komanda e ushtrisë austriake më thirri dhe më kërkoi mendim në lidhje me veprimet tekniko-ushtarake në Shqipëri dhe më detyruan që t'ju prija trupave të tyre. U nisa me karracën e Bashkisë së Shkodrës dhe i mbërrita trupat në malin e Kakariqit. Me pas mbërritëm në Lezhë dhe prej këndeje u nisëm për Krujë, ku çarmatosëm xhandarët e Esat Toptanit. Këtu u bashkuam me forca të tjera, në mes të cilave kishte ardhur dhe Murat Bej Toptani.

Komandant i ushtrisë austriake ishte Haersler. Prej këndeje, u ktheva në Shkodër, ku gjeta shokët që ishin liruar nga robnrimi në Malin e Zi, si dhe oficerët vullnetarë që kishin shkuar në Austri. Të gjithë, bashkë me Luigj Gurakuqin, u mblodhëm në shtëpinë e Fejzi Alizotit, në lagjen katolike "Bardrej", ku diskutuam çështjen e uniformës të oficerëve shqiptarë. Dallimi u bë duke vënë spaletat kuq e zi dhe në kapë inicialet "E.I." (që do të thoshte: Franc Jozefi i Parë). Këtë veprim e kundërshtova. Propozova që në kapë të vihej "W-I", që do të thotë Widi I. Por, për këtë veprim nuk gjeta përkatësi.

Komanda austriake, pasi u konsultua me komandën e përgjithshme, na detyroi që të vëmë në kapë shenjën "FI". Në bisedë me shokët oficerë, i propozova që para se të viheshim në shërbim të Austrisë, të bënim një kontratë me ta, për të mbrojtur të drejtat tona. Kjo gjë nuk u bë mbasi shokët që erdhën nga Austria thanë se ishin përbeturar njëherë për mbretin e nuk mundnin ta kërkonin një gjë të tillë. Gjithashtu, Fejzi Alizoti dhe Luigj Gurakuqi nuk ma përkrahën idenë politike të kontratës shoqërore me Austrinë. Kështu që mbetëm të nënshtuar pa asnjë të drejtë, nën sundimin e Perandorisë Austro-Hungareze.

Mbasi më mori në shërbim, Austria më dërgoi te kulla e Lumës, së bashku me një kapiten austriak, Negrep, për të themeluar administratën e Lumës, Hasit, Pejës dhe Dibrës. Shërbimi im në këtë detyrë ishte si këshilltar i komandantit të këtij qarku. Detyra ishte për të rregulluar administratën, xhandarmërinë dhe për të lëshuar

urdhëresat të administrimit austriak në Shqipëri.

Përveç kësaj, kishim për detyrë të caktonim edhe kufijtë e administrimit mes Malit të Zi, Serbisë dhe Bullgarisë.

Komanda austriake në Shqipëri u mor dhe me hetimin e ngjarjeve të zhvilluara në këtë krahinë. Siç kemi thënë dhe më parë, Austria, kishte grumbulluar para okupacionit veshmbathje dhe armatime për t'i përdorur kundra Serbisë e Malit të Zi, kur të fillonte lëvizjet ushtarake.

Sipas hetimeve që bëmë na rezultoi se në këtë luftë kishin marrë pjesë edhe Elez Isufi në krahinën e Dibrës, në Reç e Dardhë, ku i kishte shkatërruar Serbisë një divizion. Vetë Elezi, na tregoi para shtëpisë së vet, varret e 573 forcave ushtarake serbe, si dhe një sasi të madhe armatimesh në mes të cilave dhe dy mitralozat. Për këto veprime, Austria e dekoroi Elez Isufin me medaljen e "Kryqin e Oficerëve" të Urdhrit të Franc Jozefit.

Nga ana tjetër, Bajram Curri, kishte luftuar gjatë lumit të Drinit, te Ura e Vezirit dhe kishte shkatërruar një tjetër divizion të Serbisë. Megjithatë komanda austriake në Shqipëri kishte bërë propozim për dekorim edhe për Bajram Currin, këtij nuk ju dha mbasi, siç duket guvernanti austriak i Malit të Zi, ishte kundra dekorimit të Bajram Currit, të cilin e paraqiste si një brigand.

Kjo u pa edhe në rastin kur ne kërkua që Bajram Curri të vinte nga ana jonë, ai (guvernanti), mezi u bind që ta lejonte për të kaluar. Gjatë kontrolleve që bënim në vende të ndryshme, në katundin Zym të Hasit Gjakovës, konstatoam se kapteri austriak, frati i vendit, Pashko Prela, dhe drejtori i shkollës fillore, ishin bërë administrata kryesore e vendit, duke administruar edhe 13 katunde myslimane. Duke bërë shpërdorime të mëdha, ata kishin shkatërruar pakënaqësi në popull. Për këtë arsye kapiteni Negrep mori masa. Kapterin austriak e degradoi, dhe e transferoi si ushtar të thjeshtë në Galici, ndërsa fratin e dërgoi në Mal të Zi.

Mbasi isha merrtur me punët administrative, për të mos me u komprometuar në popull, vendosa të largohesha nga Kullat e Lumës dhe bëra kërkesë për të shkuar në Shkollën e Aeroplanëve, Vinermajshtag. Si përgjigje më thanë se më parë duhej të ndiqja Shkollën e Oficerëve të Rezervës, që ishte hapur pak kohë më parë në Shkodër. U fut në shkollë si dëgjues. Mbas përfundimit të shkollës më dërguan në ballë të luftës (front) në Berat. Ndërsa lufta vazhdonte, bashkë me aleatët ne formuam çetat shqiptare për t'i ardhur në ndihmë ushtrisë.

Përveç kompanisë që kisha në Kalanë e Beratit, mbasi dija gjermanisht, isha caktuar edhe në Komisionin e Informatave të Luftës. Raportet që vinin nga balli i luftës të shkruara shqip dhe turqisht, unë i përktheja në gjermanisht. Një ditë vjen një urdhër sekret nga Berlina. Ai urdhëronte Austrinë që çetave shqiptare të formuara në Epir, t'i vihej në kapë parulla " Vetëqeverimi i Epirit".

Mbas këtij urdhri, oficerët e Austrisë biseduan me oficerët grekë për të pezulluar përkohësisht luftën, për një oportunitizëm politik që Kajzeri i Gjermanisë bënte me nipin e tij Kostandinin e Greqisë, të cilin mundohesh për ta tërhequr nga vetja. Si oficerë shqiptarë ne u zumë ngushtë. Imblodha shokët oficerë në shtëpinë e Sali Nivicës, i cili kishte funksionin e sekretarit të përgjithshëm të Prefekturës së Beratit. Në mbledhje merre pjesë



dhe prefekti, Hajdar bej Kolonja, të cilin austriakët mbas katër muajsh e vranë në Gjoç.

Në mbledhje i tregova urdhrin sekret që kishte ardhur nga Berlina dhe i kërkova që secili të vepronte sipas dëshirës. Ndërsa, Shefqet Korçës, i propozova që të dezertionim e të dilnim nga ana e aleatëve, duke e ditur që ky ishte oficer karriere i frontit dhe kishte me vete shumën prej 600 napolona ar dhe 900 korona serm, që ja paguante si rroga çetave që vepronin në front. Shefqeti nuk pranoi. Atëherë unë dhashë dorëheqjen dhe vendosa të kthehem në Shkodër, së bashku me Ceko Leskovikun. Rrugës për Shkodër, ky i fundit më ftoi të kalonim natën në Teqenë e Sheh Ibrahim Karbunarës. Me këtë rast, biseduam me shehun mbi situatën politike të kohës.

Rastësisht në Shkodër takova kapiten Negrepin, i cili duke më parë të veshur civil, mori vesh dorëheqjen time. Meqenëse më njihje mirë, mbasi kishim punuar katër muaj së bashku në Kullat e Lumës, ndërhyri pranë Konsullit të përgjithshëm të Austrisë, Kral, duke i thënë se ky ishte njeri politik dhe, ose duhej marrë në shërbim ose duhej të internohej. Konsulli Kral më thirri dhe më propozoi të hyja përsëri në shërbim ushtarak, gjë të cilën fillimisht e kundërshtova, duke i thënë se nuk mund të jepja jetën për Austrinë, pa pasur asnjë arsye të drejtëpërdrejtë.

I propozova që të më emëronte mësues të gjermanishtes. Ai më dha një rekomandim për Luigj Gurakuqin, që në atë kohë ishte drejtor i përgjithshëm i Arsimit. Ai më emëroi drejtor të shkollës fillore në Perash. Mirëpo, ende pa filluar punë, Negrep ndërroi mendje, duke ndërhyrë pranë Konsullit, për emërimin tim në degën ushtarake, si definitiv në batalionin e parë shqiptar që ishte në Shkodër.

Një pjesë e mirë e oficerëve shqiptarë, duke mos qenë të aftë për të kryer si duhej detyrën, përcmoheshin nga austriakët dhe i hahej e drejta duke mos u graduar si dhe duke mos ua paguar ushqimin dhe veshmbathjen. Për të kërkuar të drejtat e tyre ata më caktuan mua për shkuar në armatën superiore në Vjenë, si përfaqësues i tyre, duke më dhënë 2000 korona, për shpenzimet e udhëtimit.

Mbasi u takova me personalitetet ushtarake të Vjenës, ju sigurova shokëve të drejta të barabarta me oficerët e Austrisë.

Përveç çështjeve ushtarake, parashtrava dhe katër pika të tjera që i përkisnin administratës civile. E para, u thashë se në kohën kur konsullata e Austriake në Shkodër kish mbetur pa pare, i kish marrë hua 600 napolona ari dy personave shkodranë dhe mbas ardhjes së Austrisë në Shkodër, ia pagoi atyre me një kurs më të ulët.

E dyta, korparmata e nëntëmbëdhjetë austriake kishte ndërhyrë pranë drejtorisë së financave të Shkodrës, për të marrë tokë për themelimin e Kishës Rozafa, duke e detyruar atë që të bënte tapi në favor të Kishës, për 1283 metra katrore. Ky veprim ishte i jashtëligjshëm mbasi, korparmata nuk i takonte të ndërhynte në çështje administrative civile. E treta,

protestova për thim që ishte therur në xhami, në fushën Çele, në prani të xhandarmërisë të pranishme në xhami dhe se ky përbente një faj për administratën e tyre.

E katërta, ushtria austriake në Myzeqe e paguante një buallicë 10 korona letër, një lopë pesë korona letër, dhe një dele dy korona letër. Kjo ishte një grabitje që i bëhej popullit shqiptar nga ana e tyre. Për të gjitha këto çështje, mbasi erdhi një komision prej tre vetash nga Vjena, u morën masat e nevojshme. Dhe, administrimi i Austrisë në Shqipëri, pati kudo përmirësime.

Mbas largimit të Austrisë, shtetit shqiptar i mbetën si tepicë në ekonomi 33 milionë korona serm. Në këtë kohë filloi përsëri aktivitetin "Krahu Kombëtar". Meqenëse në Shkodër u formua edhe Komiteti i Kosovës, nën kryesinë e Hoxhë Kadri – Prishtinës, u bë unifikimi i dy komiteteve dhe Hoxhë Kadria mbeti kryetar i përgjithshëm. Detyra kryesore e Komitetit ishte të bënte unifikimin e mendimeve dhe të shpëtonte kufijtë e 1913-ës, duke luftuar në mënyrë të hapur vendimin e Traktatit të Fshehtë të Londrës të vitit 1915.

Aleatët ia kishin premtuar me rrena Shqipërinë Italisë, për ta tërhequr nga krahu i tyre. Për këtë çështje erdhi nga Anglia anglezi që çalonte, Eden, dhe u takua me Abd bej Toptanin të cilit i kërkoi që të çoheshin dhe të kërkonin rrezimin e traktatit të vitit 1915. Për këtë qëllim, Edeni i dërgoi një letër Aqif pashë Elbasanit, letër të cilën vetë Aqif Pasha ma ka treguar. Më vonë, pashai këtë letër ia ka dërguar Nolit për sqarim politik, por, meqenëse Noli ishte me vijën politike ruse, nuk e mori aspak në konsideratë këtë letër. Propaganda kombëtare e komitetit bëhej me anë të gazetës "Populli" që nxirte në Shkodër Mustafa Qulli me Sali Nivicën dhe anëtarët e tjerë. Në këtë kohë vjen në Shkodër Luk Luka – ministër i Arsimit në qeverinë e përkohshme shqiptare të Selanikut, të kryesuar prej Esat pashë Toptanit, duke sjellë me vete një tog letrash të shkruara turqisht nga sekretarët e Esatit.

Mes tyre ishte dhe një letër e shkruar turqisht nga Esati, i cili na kërkonte t'i bënim një propozim Sulçë beg Bushatit, për të marrë pjesë në qeverinë e përkohshme të Selanikut, të kryesuar prej tij. Kërkohej gjithashtu të përkrahej Esati dhe të pranoheshi si Princ i Shqipërisë, gjë të cilën vetë Esadi e kërkoi dhe në Konferencën e Paqes në Paris, me anë të një memorandumit që i parashtrroi Konferencës, një broshurë të shkruar frëngjisht "Memuar sur l'Albani".

Unë u njoftova nga Mali Gjyli – ministër i Tregtisë së Esatit – që Luk Lukën, ta kishim nën kontroll, mbasi i ishte imponuar nga Serbia dhe ata nuk ia kishin besën.

U ngarkova me mision të fshehtë nga komiteti për të shkuar në Beograd, për të ftuar Nexhip bej Dragën që të vinte për të formuar shtetin shqiptar. Po ashtu, u ngarkova për të shkuar në Selanik, për të marrë programin e Esat Pashës. Nexhip bej Draga, propozimin që i bëra për të ardhur në Shqipëri për të themeluar shtetin shqiptar, nuk e pranoi, duke më sugjeruar si themelues të shtetit shqiptar, Mehdi bej Frashërin.

Ai kishte mendimin se qeveria më së pari duhej të themelohej në Toskëri, mbasi ata i konsideronte më të zhvilluar se ne, më pas në Shqipërinë e Mesme, e më në fund në Shkodër, bashkë me klerin katolik. Mbasi të bëhej një koalicion i përgjithshëm e të konsolidohej

shteti shqiptar, duhej me menduar për bashkimin e Kosovës dhe Çamërisë. Në bisedë me Nexhip bej Dragën, ai më tha se duhej të ikja sa më parë mbasi sipas tij serbët nuk dinin politikë dhe rezikoja të më vrisnin. Ai më këshilloi gjithashtu që shqiptarët e shkolluar, të pakët në numër, si unë me shokë, duhej të ruheshim se mos na vrisnin, dhe shkonim kot.

Mbasi, sipas tij, shumica e parisë së Shqipërisë, ishin mësuar me rroga të majme nga kasa e Turqisë, dhe tani lakmonin kasat e varfra të Vlorës dhe Durrësit, kish rrezik që ta mbysynin Shqipërinë. Duke dashur të m'i shpjegonte më mirë punët më tha: "A e din si asht ba major Hysen beg Fusha"? – Jo i thashë. Ai më tregoi se Hysen begu, doli me mirditas në Gomsiqe e preu rrugën Shkodër-Prizren, preu telat e telegrafës. Konsullatat protestuan për këtë ngjarje, në Stamboll. Sulltan Hamidi, pas hetimeve që bëri, dha vendimin që Hysen beg Fusha të bëhet major xhandarmërie, për të ruajtur po këto rrugë. Kur e mori vesh këtë punë Hysen beg Shazi, doli edhe ai e preu rrugën në mal të Kakariqit, preu telat e telegrafës, ndali postën. Prapë protestat të konsujve. Atëherë Sulltani edhe këtij i vuri një strajcë për të "kullotur", duke e bërë edhe këtë major xhandarmërie, për të ruajtur rrugën Shkodër-Lezhë-Tiranë. Në këtë kohë, Ibrahim bej Sokoli, që kish qenë në Stamboll te Tahir pashë Dragoviçi, vjen në Shëngjin me vapor, del në breg e pyet: "Ç'kena ka Shkodra?". Ata i tregojnë se Hysen begu i Fushës dhe Hysen beg Shazi, janë bërë majorë xhandarmërie. Ky zotni, pa ardhur në Shkodër, me po atë vapor kthehet për Stamboll për të kërkuar edhe ai një strajcë për të ngrënë, mbasi ishte shtëpi më e madhe. Edhe këtë sulltani e gradoi kolonel. Në Stamboll, Preng Pasha, Gani bej Toptani dhe Esat Toptani, jetonin në lagjen "Bejoll" të Stambollit. Mirëpo qisnin pushkë orë pa orë, deheshin e bënin zhurmë, duke e bezdisur Sulltan Hamidin, poshtë në "Dollma Bahçe". Atëherë, Sulltan Hamidi, Preng Pashën e dërgoi në internim në Anadol, Esat Pashën e dërgoi kolonel xhandarmërie në Janinë, ndërsa Gani bej Toptanin, që kishte rënë në dashuri me të bijën e Vezirit të Madh, e vrau me vëllain e vajzës.

Kështu që Sulltan Hamidi, shpëtoi prej kësaj belaje që kishte mbi kokë. Në Gjakovë, vazhdoi të tregonte Nexhip beu, kërcet pushka në mes të Riza beg Kryeziut dhe Bajram Currit e, prishet posta Prizren-Shkup. Edhe këta, si të parët, sulltani i gradoi: Riza begun e bëri major, Bajram Currin kapiten, Hysni Currin kryekapiter. Nexhip Begu, vazhdoi të tregonte kohën kur ishte deputet në Parlamentin e Turqisë, bashkë me Hasan Prishtinën, Ismail Bej Vlorën. Ne ngulnim këmbë për të drejtat e Shqipërisë, autonominë, kulturën, gjuhën e qytetërimin, mirëpo xhonturqit bënin propagandë në popullin e Kosovës, të cilin e ngritën në këmbë kundra nesh. Njerëzit vijën në Kaçanik e i bëjnë telegraf Stambollit, duke i kërkuar që një person me emrin Nexhip, i cili bën propagandë atje, ne nuk e njohim aspak si deputetin tonë.

Një ditë duke ndenjur në kafe "Ballkan" në Beograd me Nexhip begun, i fola për trimërinë dhe vdekjen burrërore të Isa Buletinit, të cilin e prenë në besë malazezët.

/Memorie/ll



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Zyrtare: Higuaini pensionohet nga futboli

MIAMI, 18 TETOR - Gonzalo Higuain e ka zhvilluar ndeshjen e fundit si futbollist profesionist. Inter Miami është mposhtur me rezultat 3:0 nga New York City në ndeshjen e raundit të 1/8 në MLS, ndërkohë që Higuaini nuk u është përmbajtur lotëve dhe është shfaqur tejet

i emocionuar pas ndeshjes. "Ëndrra mbaroi këtu. Tani fillon një jetë tjetër e re. Mbi 17 vjet karrierë dhe kështu shkoi gjysma e jetës sime. M'u kujtua e gjithë karriera ime. Po largohem shumë i lumtur sepse kam dhënë gjithçka nga vetja", ka thënë sulmuesi i njohur argjentinas

pas ndeshjes lamtumirëse. 34-vjeçari ka shënuar 366 gola dhe ka regjistruar 127 asistime në 784 ndeshje. Ka fituar tituj me Real Madridin, Napolin, Juventusin dhe Chelsean, gjithsej 14 trofe. Kurse me kombëtaren e Argjentinës është shpallur nënkampion botëror në vitin

2014 dhe dy herë nënkampion në Amerikën Latine. "Një shoku im i skuadrës më thoshte gjithmonë se duhet të tërhiqesh ti nga futboli dhe jo futboli nga ti. 'Duhet të ndalesh kur të jesh ende në formë', insistonte ai", ka thënë Higuaini.



Karim Benzema shpallet lojtari më i mirë në botë

PARIS, 18 TETOR - Karim Benzema është shpallur të hënën mbrëma lojtari më i mirë në botë, duke e rrëmbyer për herë të parë "Topin e Artë". Ky çmim i është dhënë Benzemas nga "France Football". Ylli i Real Madridit ka pasur ndikim të jashtëzakonshëm në triumfin e "Los Blancos" në Champions League edicionin e kaluar dhe kjo i është përkthyer në "Top të Artë". Në ceremoninë e organizuar nga "France Football" në Paris janë ndarë edhe disa çmime të tjera. Pablo Gavi i Barcelonës është shpallur lojtari më i mirë U21 në

botën e futbollit. Po ashtu, futbollistja e Barcelonës, Alexia Putellas, është shpallur edhe zyrtarisht lojtarja më e mirë në botë. Ekipi më i mirë në botë është shpallur Manchester City, portieri më i mirë Thibaut Courtois i Real Madridit dhe golashënuesi më i mirë është shpallur ish-lojtari i Bayernit dhe Barcelonës, Robert Lewandowski. Ndërsa ish-lojtari i Liverpoolit dhe Bayernit, Sadio Mane, ka fituar çmimin "Socrates", i cili ndahet mbi baza humaniste për lojtarët që prekin probleme sociale.



Zbulohet paga e Armando Brojës te Chelesa

LONDËR, 18 TETOR - Armando Broja po vazhdon përpjekjet për ta realizuar ëndrrën e tij që të bëhet një futbollist protagonist te Chelsea përkundër konkurrencës së fortë që e ka në fazën e sulmit sidomos nga Aubameyang, Havertz dhe Sterling. Por, sulmuesi shqiptar po e pret çdo shans për ta fituar besimin e trajnerit Graham Potter. 22-vjeçari i Kombëtares shqiptare ishte i huazuar për një vit te Southamptoni ku pati paraqitje fantastike, me të cilat e detyroi Chelsea ta kthejë në skuadër dhe të mos e shesë kartonin e tij për asnjë çmim te shumë klube

të mëdha që kishin shprehur interesim për Brojën. Madje klubi londinez kishte vendosur t'ia ofrojë një pagë mjaft të mirë Brojës. Sipas "Forbes" dhe "Business Insight", Broja i përfiton rreth 1.5 milion euro neto në sezon nga Chelsea. Kjo është vetëm paga e Brojës, i cili sigurisht se përfiton edhe më shumë se kaq përmes reklamave dhe sponsorëve të ndryshëm. Javë më parë Chelsea e ka vazhduar kontratën me Armando Brojën edhe për gjashtë vjet. Me këtë kontratë të fundit, sulmuesi do të qëndrojë në "Stamford Bridge" të paktën deri në vitin 2028.

Messi: Franca dhe Brazili, favoritë për Kupën e Botës

Paris, 18 tetor - Lionel Messi ka dhënë disa komente lidhur me Kampionatin Botëror Katar 2022. Ikona argjentinase e futbollit, Lionel Messi, ka kthyer gjithë vëmendjen e tij kah kombëtarja e Argjentinës. Në muajin tjetër, Messi synon që

me skuadrën kombëtare ta fitojë trofeun e vetëm që i mungon - Kupën e Botës. I pyetur për kampionatin dhe favoritët, Messi ka dhënë 5 favoritë, por jo kombëtaren e tij. Dy kombëtares më të forta ai i sheh Francën dhe Brazilin. "Sa për favoritët,

shoh shumë skuadra të mëdha si Brazili, Gjermania, Franca, Anglia dhe Spanja. Dhe sigurisht se po e harroj ndonjë, por nëse duhet të mbaj vetëm dy sot, mendoj se Brazili dhe Franca janë dy kandidatë për këtë kupë bote", ka thënë Messi.

Kombëtarja e Argjentinës është në një seri pa humbje që nga viti 2019. Shumë njerëz e shohin Argjentinën në mesin e favoriteve, më shumë edhe për shkak të Lionel Messit, por edhe pas triumfit në Kupën e Amerikës.



Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE**Bilanci i gjendjes me : 30.09.2022****Euro'000**

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Pasurite		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	11,498	10,521
Kërkesat ndaj bankave	2,028	1,299
Bonot e thesarit	-	-
Investimet në letra me vlerë	6,115	6,121
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	80,419	91,457
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,527	1,418
Pasuritë e paprekshme	172	155
Pasuritë tatimore të shtyra	-	-
Pasuritë tjera	238	137
Gjithsej pasuritë	101,997	111,108
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	75,059	76,103
Detyrimet ndaj bankave	16,080	24,248
Fondet tjera të huazuara	-	-
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	853	872
Gjithsej detyrimet	91,992	101,224
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	10,000	10,000
Rezervat e kapitalit	-	-
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	504	504
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	509	389
Përbërësit tjerë të ekuitetit	-	-
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	10,005	9,885
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve	101,997	111,108

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE**Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 30.09.2022****Euro'000**

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	2,386	3,819
Shpenzimet e interesit	693	1,130
Neto të hyrat nga interesi	1,692	2,689
Të hyrat nga tarifave dhe komisionet	277	405
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	83	136
Neto të hyrat nga tarifave dhe komisionet	194	269
Neto të hyrat nga tregtimi	9	16
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	-	-
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	765	1,271
Gjithsej të hyrat	1,131	1,702
Provizionet për humbjet nga kreditë	582	1,254
Provizionet tjera	3	4
Fitimi/(humbja) para tatimit	546	445
Shpenzimet e tatimit në fitim	37	56
Shpenzimet e tatimit të shtyer	-	-
Fitimi/(humbja) neto	509	389
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	509	389

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Newco Agromorava” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810510835 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit, Shaban Ismajli nr. tel: 044-194-334. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Newco Agromorava” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810510835 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije, Shaban Ismajli, nr. tel: 044-194-334.. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Newco Agromorava” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810510835 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process, Shaban Ismajli, nr. tel: 044-194-334. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Newco Agromorava" L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810510835 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit, Shaban Ismajli nr. tel: 044-194-334. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Newco Agromorava" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810510835 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije, Shaban Ismajli, nr. tel: 044-194-334.. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Newco Agromorava" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810510835 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process, Shaban Ismajli, nr. tel: 044-194-334. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arber Zeqiraj shpall të pavlefshme diplomën e Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Xheladin Deda" në Mitrovicë, në vitin 2018.

- Luljeta Shaqiri shpall të humbur diplomën e masterit, të lëshuar nga Kolegji UBT, drejtimi: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomiks.

- Gjon Paluca shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Rejall Shope shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

- Lorena Binaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Vëllezërit Frashri " Pllanej.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L